



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 514/11 prot.

Tiranë, më 27.02.2025

VENDIM
Nr. 28, datë 27.02.2025

PËR
“DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATAVE”, E NDRYSHUAR”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 37, 38 dhe 79; në Statutin e UMT-së, nenet 5, 25, 26, pika 1, shkronja “s” dhe 88; në Rregulloren e UMT-së, neni 78, si dhe në Rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, e ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Në Rregulloren “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, e ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
- Në nenin 2, *Organet përgjegjëse*, pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:
3/1 *Koordinatori i programit të studimit të doktoratës është drejtuesi i njësisë bazë që ofron programin. Në rastet e programeve të përbashkëta të doktoratave, njësitë bazë bashkëpunuese në ofrimin e programit caktojnë në dakordësi një koordinator të programit. Koordinatori i programit të studimit nuk mund të jetë Zv.Dekani për kërkimin shkencor, për shkak se është përgjegjës i programeve të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore.*
3/2 *Në rastet kur koordinatori i programit të studimit ose përgjegjësi i programeve të studimit në nivel njësie kryesore, mbush moshën e pensionit, ai i humbet këto funksione dhe njësia kryesore merr masa për zëvendësimin e tij.*
 - Në nenin 4, *Procedura për hapjen e programeve të studimit të doktoratës*, bëhen këto shtesa:
 - Pas shkronjës “k”, shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:
 - Listën e personelit akademik të kategorisë “Profesor” të njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave, me numrin e udhëheqjeve/bashkëudhëheqjeve në momentin e paraqitjes së aplikimit, dëshmitë e titujve akademikë dhe kontratat e punës ose vërtetimin e Rektorit të UMT-së;*
 - Në pikën 4 shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

Vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miratojnë hapjen/riorganizimin e programit/eve të studimit, duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi (kur zhvillojnë lëndë deri në 30 kredite), si dhe kodin e tij.

iii. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2 me këtë përmbajtje:

4/1 Në rast se, për hapjen e programit të studimit, kërkohet financim nga buxheti i shtetit depozitohet edhe miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vetë UMT-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit duhet të jetë e shprehur masa e financimit të plotë gjatë kohëzgjatjes së programit që do të mbulohet nga të ardhurat e institucionit dhe nuk do të kërkohet financim shtesë nga buxheti i shtetit.

4/2 Në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër të huaj të arsimit të lartë për hapjen/riorganizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhën shqipe, i përkthyer dhe njehsuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë: i. aktin e akreditimit të programit të studimit; ii. marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i personelit akademik, lloji i diplomës, etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore.

3. Në nenin 6, *Kërkesat themelore dhe procedurat për regjistrimin e kandidatëve*, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në pikën 1, shkronja “c” hiqet fjalia e dytë.

ii. Në pikën 1, pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i”, me këtë përmbajtje:

i. Të mos jetë duke ndjekur një program tjetër studimi.

iii. Në pikën 2, fjalia e parë riformulohet me këtë përmbajtje:

2. Njësitë bazë mund të propozojnë edhe kritere preferenciale të tilla si:

iv. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

2/1 Në vlerësimin e kandidatëve, merren në konsideratë kriteret e miratuara, sipas raporteve në vijim:

<i>a) Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të dytë</i>	<i>20 pikë</i>
<i>b) Projekt propozimi për kërkimin shkencor</i>	<i>30 pikë</i>
<i>c) Eksperienca në mësimdhënie</i>	<i>10 pikë</i>
<i>d) Veprimtaria botuese, pjesëmarrja në projekte kërkimore</i>	<i>10 pikë</i>
<i>e) Eksperienca profesionale</i>	<i>10 pikë</i>
<i>f) Kualifikime shkencore/profesionale (specializim, master ekzekutiv, trajnim mbi 6 muaj pa ndërprerje)</i>	<i>10 pikë</i>

g) *Kritere të tjera preferenciale të vendosura nga njësia bazë/njësiti bazë* 10 pikë

v. Në pikën 3, ndryshohen shkronjat “f”, “j”, “n” dhe shtohet shkronja “r” me këtë përmbajtje:

(f) 2 (dy) rekomandime nga personel me titull akademik në fushën e shëndetit;

j) deklaratë e një prej udhëheqësve shkencorë të miratuar në programin përkatës të studimit se, projekti i kërkimit shkencor të propozuar nga kandidati është i përshtatshëm për aplikimin për studime të doktoratës në këtë program. Një udhëheqës shkencor mund të lëshojë më shumë se një deklaratë udhëheqjeje.

n) platforma e disertacionit dhe plani i punës i ndarë në vite, hartuar dhe nënshkruar nga kandidati;

r) vetëdeklarim i aplikantit se, nuk është duke ndjekur një program tjetër studimi.

vi. Në pikën 4, ndryshohet fjalia e dytë, me këtë përmbajtje:

Dekanati publikon metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, në faqen zyrtare të çdo njësie kryesore, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve përpara datës së mbylljes së aplikimeve.

vii. Në pikën 4, ndryshohet shkronja “a” me këtë përmbajtje:

a. *Komisioni ad hoc, pas verifikimit të përmbushjes së kritereve themelore, bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, sipas fushave/nënfushave të programeve të studimit të doktoratës, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, referuar një liste të qartë dhe transparente mbi pikëzimin e kritereve specifike të aplikantëve. Lista e kandidatëve të përzgjedhur e të listuar në rend zbritës nga Komisioni ad hoc miratohet në mbledhjen e njësisë bazë dhe përcillet për publikim paraprak tek drejtuesi i njësisë kryesore.*

viii. Pas pikës 5, shtohet pikat 5/1 me këtë përmbajtje:

5/1 Pas përfundimit të procesit të ankimimit, Komisioni ad hoc vendos përfundimisht udhëheqësit shkencorë sipas renditjes së kandidatëve dhe propozimeve të kërkimit shkencor. Nëse e vlerëson, në këtë mbledhje Komisioni mund të ftojë edhe kandidatët fitues të programit.

ix. Pika 6 ndryshohet me këtë përmbajtje:

6. Lista e kandidatëve fitues, e udhëheqësve shkencorë përkatës dhe projekteve kërkimore fituese përcillet për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore, shoqëruar me një relacion shpjegues për punën e kryer, sipas çdo fushe/nënfushe. Drejtuesi shqyrton dokumentacionin dhe procedurat e kryera dhe e përcjell praktikën e plotë në Rektoratit e UMT-së. Pas miratimit nga Rektori i UMT-së, drejtuesi i njësisë kryesore publikon listën e kandidatëve fitues.

x. Pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

6/1 Rektorati i UMT-së gëzon të drejtën e monitorimit të procesit të aplikimit dhe shpalljes së fituesve në këto programe studimi.

4. Në nenin 8, *Kërkesat themelore të punës për realizimin e programit të studimit të doktoratës*, bëhen shtesat me këtë përmbajtje:

i. Në pikën 1, shkronja “b”, pas fjalisë së parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

2 (dy) artikuj shkencorë të jenë botuar si autor i parë në revista shkencore brenda vendit (të njohura nga UMT) ose ndërkombëtare të indeksuara.

ii. Në pikën 3, në fjalinë e dytë, pas togfjalëshit “*njesisë bazë*” shtohet togfjalëshi “*njësive bazë*”.

5. Në nenin 12, *Përgjegjësitë e njesisë bazë* bëhen këto shtesa:

i. Në pikën 9, pas fjalisë së dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

Ndryshimi i temës së disertacionit është i mundur vetëm 1 (një) herë dhe vetëm gjatë vitit të parë të programit të studimit. Në këtë rast, kohëzgjatja e programit të studimit, rifillon nga data e vendimit për miratimin e ndryshimit të temës së disertacionit.

6. Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

Neni 12/1

Ndryshimi i udhëheqësit shkencor

- 1. Pas regjistrimit të kandidatit në programin e studimit të doktoratës, nëse lind nevoja e ndryshimit të udhëheqësit shkencor, ky i fundit i drejtohet me kërkesë të argumentuar njesisë bazë përkatëse, duke kërkuar dorëheqjen nga udhëheqja e kandidatit.*
 - 2. Njësia bazë pas shqyrtimit të kërkesës për dorëheqjen e udhëheqësit shkencor, në eventualitet të miratimit të saj, nëpërmjet dekanit të fakultetit e përcjell për miratim në Senatin Akademik të UMT-së, shoqëruar me vendimin e miratimit nga njësia bazë, propozimin për udhëheqësin e ri, dëshminë e titullit akademik që mban udhëheqësi, kontratën e punës dhe letrën e angazhimit të tij.*
 - 3. Si rregull, ndryshimi i udhëheqësit shkencor është i mundur gjatë vitit të parë të programit të studimit, përveç rasteve madhore.*
 - 4. Në rastin e ndryshimit të udhëheqësit shkencor, si i tillë do të konsiderohet udhëheqësi që ka miratuar tezën e disertacionit.*
 - 5. Vendimi i Senatit Akademik dhe dokumentacioni justifikues për miratimin e ndryshimit të udhëheqësit shkencor i përcillen për miratim Ministrisë përgjegjëse për arsimin.*
7. Në nenin 15, *Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës*, bëhen këto ndryshime dhe shtesa me këtë përmbajtje:
- i. Në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet kjo fjali me këtë përmbajtje:

Afati i studimeve në programin e doktoratës fillon nga dita e nesërme e regjistrimit të kandidatit në program.

ii. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

2. *Afati i përfundimit të studimeve të doktoratës pezullohet ose shtyhet me kërkesë të vetë kandidatit, kur ai nuk mund të vazhdojë rregullisht këtë program studimi për arsye objektive të përligjura (sëmundje të rënda, fatkeqësi, etj.), të cilat vlerësohen rast pas rasti. Në çdo rast, arsyet për të cilat kërkohet shtyrja/pezullimi duhet të jenë të dokumentuara. Kërkesa për shtyrje paraqitet kur studenti i doktoratës, konstaton se, nuk arrin të përmbyllë projektin e tij kërkimor brenda afatit të përcaktuar.*

iii. Në pikën 3, pas fjalisë së parë shtohet kjo fjali me këtë përmbajtje:

Në të dyja rastet, kërkesa për shtyrje/pezullim, duhet të jetë e miratuar nga udhëheqësi i doktoratës.

iv. Pika 4 riformulohet me këtë përmbajtje:

4. *Njësia bazë përkatëse ngre një komision ad hoc, i përbërë nga 3 (tre) anëtarë personel akademik i kategorisë “Profesor”, për të shqyrtuar ekzistencën e kushteve për shtyrjen/pezullimin e programit të studimit, si edhe pasojat juridike apo financiare. Në vijim, përmes drejtuesit të njësisë bazë, komisioni ad hoc përcjell për miratim tek drejtuesi i njësisë kryesore, propozimin së bashku me dokumentacionin justifikues.*

v. Në pikën 5, pas shprehjes “pezullim” shtohet shprehja “shtyrje”.

8. Në nenin 18, *Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës*, në pikën 2, shkronja “a”, pas fjalisë së parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

Dosja duhet të depozitohet jo më parë se 3 (vjet) nga dita e nesërme e regjistrimit të kandidatit në program.

9. Në nenin 27, pas pikës 2 shtohet shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. *Ky Vendim zbatohet për aq sa është e mundur, edhe për studentët të cilët janë duke ndjekur një program studimi të ciklit të tretë të doktoratës në UMT.*

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, njësitë kryesore dhe Drejtorja e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit në Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

PROF. DR. XHELADIN DRACINI

